



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 12, datë 25.02.2020

Për

Miratimin e rinovimit të kontratës së dhënies në përdorim për shfrytëzim minerale ndërtimi zhure në objektin Kosmaç, "Subjektit Alba Beton 07" sh.p.k.

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 25.02.2020, me propozim të kryetarit të Bashkisë ,mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja "e", të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 19 pika 1,1/1 e ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 "Për fondin pyjor" i ndryshuar", pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" pika 3 ;4 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.7.2016 të Ministrisë së Mjedisit "Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" me shumice të cilësuar të votave

V E N D O S I :

1. Rinovimin e kontratës së dhënies me qira për shfrytëzim të Mineraleve të ndërtimit,zhure sipas vendimit të **Këshillit Bashkisë nr.40,datë 21.06.2018** në ekonomine pyjore Drin Gjadër Kirë ,ngastrat **nr 11,12** subjektit **Alba Beton 07.Sh.p.k.**
2. Miratimin e ngastrës **nr.13** në ekonomine Pyjore Drin Gjadër Kirë djerre për rrugë kalimi për lidhjen e ngastrave **nr.11;12** në ekonomine pyjore Drin Gjadër Kirë , me gjatësi prej **1.1 km(ose 0.33 ha)**,objekt i shfrytëzimit të mineraleve të *ndërtimit zhure*.
3. Afati i rinovimit të kontrates të jetë **1(një) vit** sipas planit vjetor të shfrytëzimit të miratuar nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore(AKBN) .
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 dt 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore",i ndryshuar.
5. Ky vendim u shpall sot me dt 02.03 2020

KRYETARI
Mark Bisha

SEKRETARI
Ardian Celepija

